




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar / Prilbjen / Me Datën 27.03.2025			
Nr. Llogarit Org. Breg	Nr. Breg	Nr. Breg	Vlera Vrednost
01-	110/05-	259	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17, pika 2 lidhur me pikën 6 të Ligjit për Dhënien e Pronës së Palujtshme të Komunës në Shfrytëzim Nr.06/L-092, neni 17, paragrafi 1 dhe 2 i Rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së palujtshme të komunës, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.03.2025 miraton këtë:

V E N D I M

për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës

Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurt, deri 15 vite (pesëmbëdhjetë vite), për Njësin Kadastrale me Nr.P-70101005-00630-0, në zonën kadastrale në Terpezë, pjesa prej 300 m². Sipas çartifikatës së pronës, evidentohet në pronësi të Komunës së Vitisë.

Komisioni përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve si në vijim:

1. Fatmir Salihu, anëtar i komisionit, përfaqësues i ekzekutivit të komunës.
2. Fitim Selmani, anëtar i komisionit, përfaqësues i ekzekutivit të komunës.
3. Ekrem Ymeri, përfaqësues i kuvendit të komunës.
4. Liridona Bislimi, përfaqësues i kuvendit të komunës.
5. Shyqeri Halabaku, përfaqësues i sektorit joqeveritar.

Neni 2

Detyrat e komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës Nr.06/L-092, i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me Nr.10, të datës 03.04.2019) dhe Rregullorës Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së palujtshme të komunës.

Neni 3

Kuvendi i Komunës së Vitisë e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarve të komisionit, kurdoherë që kërkohet.

Neni 4

Obligohet Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me Komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurt të pronës së palujtshme të komunës, t'i zhvilloj procedurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës, anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit në Komunën e Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 10 pika 6, të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Anëtarve të komisionit;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi